



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 24, paragrafët 1, 2, dhe 25, paragrafët 1, 2, dhe 6 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 10/03, prill 2019), dhe të nenit 33.2, shkronja a, dhe nenit 34.1, shkronja d, të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 9.10.2023, merr këtë

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Qamil (Ismet) Bullatovcit, Agron (Ismet) Bullatovcit, Bajram (Muharrem) Bullatovcit dhe Bujar (Muharrem) Bullatovcit.
- II. Prona e paluajtshme komunale që do të jepet në këmbim, ka këto karakteristika:
 1. Pjesa e parcelës kadastrale, nr. 02997-4, me sipërfaqe 461 m², Certifikata e pronësisë, nr. P-71914059-02997-4, Zona kadastrale Prishtinë, në pronësi P.Sh. rrugë, KK Prishtinë, me destinim ndërtim, sipas Planit rregullues "Muhaxhirët", i miratuar sipas Vendimit nr. 01, nr. 35-1299, të dt. 29.06.2010 dhe Planit zhvillimor urban, të miratuar me Vendimin nr. 01 nr.035-181427, të dt. 24.9.2013.
 2. Kurse prona e paluajtshme që merret nga ky këmbim, është pjesa e parcelës kadastrale nr. 00055-0, me sipërfaqe 461 m², Certifikata e pronësisë, nr. P-71914050-00055-0, Zona kadastrale Matiçan, Prishtinë, në pronësi të Qamil (Ismet) Bullatovcit, Agron (Ismet) Bullatovcit, Bajram (Muharrem) Bullatovcit dhe Bujar (Muharrem) Bullatovcit, me destinim rrugë të planifikuar dhe pjesërisht gjelbërim, sipas Planit rregullues "Mati 1", i miratuar sipas Vendimit nr. 01, nr. 35-642, të dt. 01.04.2010.
- III. Këmbimi i pronave të paluajtshme me pronarët e cekur në pikën II të këtij Vendimi, është bërë për shkak të realizimit të Planit rregullues "Muhaxhirët", i miratuar me Vendimin nr. 01. nr. 35-1299, dt. 29.6.2010 dhe Planit zhvillimor urban të miratuar me Vendimin nr. 01. nr. 035-181427, të dt. 24.9.2013.
- IV. Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronës private, ku do të përcaktohen sipërfaqet e sakta të këmbimit.
- V. Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarit të parcelës kadastrale që do të këmbëhet.

- VI.** Pronat e paluajtshme komunale që do të këmbehen, të përshkruara në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastralë të Komunës.
- VII.** Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- VIII.** Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:
- skica grafike,
 - kopjet e planit dhe
 - certifikatat e njësisë kadastrale.
- IX.** Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-463/03-204173/23, më 10.10.2023

KRYESUESI I KUVENDIT
Pëllumb Bajrosinova



Arsyetim

Drejtoria e Urbanizmit me Vendimin për përcaktimin e kushteve ndërtimore 05. nr.350/02-261814/21, dt. 21.10.2023, ka dhënë pëlqimin për këmbimin e pjesës së parcelës kadastrale, nr. 2997-4, sip. 461m², Zona kadastrale Prishtinë, në pronësi P.Sh. rrugë, Komuna e Prishtinës, të cilat gjenden në kuadër të bllokut urban "B-18", nëntërësisë "B-4" të tërësisë "B", Planit rregullues "Muhaxhirët", i miratuar me Vendimin nr. 01 nr.35-1299, dt. 29.06.2010, të Kuvendit të Komunës së Prishtinës dhe Plani zhvillimor urban të miratuar me Vendimin 01. nr. 035-181427, dt. 24.9.2013, të Kuvendit të Komunës së Prishtinës dhe pjesa e parcelës kadastrale nr. 55-0, me sip. 461m², ZK Matiçan, Prishtinë, në pronësi të Qamil (Ismet) Bullatovcit, Agron (Ismet) Bullatovcit, Bajram (Muharrem) Bullatovcit dhe Bujar (Muharrem) Bullatovcit, me destinim rrugë të planifikuar dhe pjesërisht gjelbërim, sipas Planit rregullues "Mati 1" i miratuar me Vendimin 01. nr. 35-642, dt. 01.04.2010, të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

Propozimi për iniciimin e këmbimit të parcelës/ave të tokës me pronarët e cekur në pikën II, është bërë për shkak të realizimit të Planit rregullues "Muhaxhirët", i miratuar me Vendimin 01. nr.35-1299, dt. 29.06.2010, të Kuvendit të Komunës së Prishtinës dhe Plani zhvillimor urban, të miratuar me Vendimin 01. nr.035-181427, dt. 24.09.2013, të Kuvendit të Komunës së Prishtinës. Parcela nr. 2997-4, Zona Kadastrale Prishtinë, shtrihen në zonë të planifikuar për ndërtim, ndërsa pjesa e parcelës nr. 55-0, me sip. 461m², ZK Matiçan, Prishtinë, sipas Planit rregullues "Mati 1", i miratuar me Vendimin 01. nr.35-642, dt.1.4.2010, të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, shtrihet rrugë të planifikuar dhe pjesërisht gjelbërim.

Procedura e këmbimit të pronës komunale me pronë private, është duke u zhvilluar në bazë të nenit 25 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 10/03, prill 2019).

Andaj, duke u bazuar në dispozitat ligjore të cilat janë të përshkruar në pjesën hyrëse të këtij propozimi dhe në shkresat e lëndës, propozojmë që të bëhet këmbimi i pronës komunale me pronë private, siç është përshkruar në pikën II të dispozitivit të këtij propozimi.